



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PREDSIEDLA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 287 Nr. i faq./Br.str/No.pg 372		
Data/Datum/Date 10 / 5 / 22		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR RREGULLLOREN PËR DHËNIEN E TITUJVE TË NDERIT, DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE NGA KOMUNA E RAHOVECIT

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Duke duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe Nenit 6 pika 1.1 të Udhezimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Zyra për Informim në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal të Rahovecit, bën njoftimin për:

KONSULTIM PUBLIK

PËR RREGULLOREN PËR DHËNIEN E TITULJE TË NDERIT, DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE NGA KOMUNA E RAHOVECIT

Me 28.03.2022, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për **Rregulloren për dhënie e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit**. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës, facebookun e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike. Në të njëjtën ditë janë njoftuar përmes emailit drejtorët e shkollave dhe përfaqësuesit e OJQ-ve që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, ndërsa përmes rrjetit social viber janë njoftuar kryetarët e fshatrave-lagjeve të komunës dhe përfaqësuesit e OJQ-ve.

1. Publikimi në uebfaqe: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/03/Njoftim-publik-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-rregulloren-per-dhenien-e-titujve-te-nderit-mirenjohjeve-dhe-dekoratave-te-Komunes-se-Rahovecit.pdf>
2. Publikimi facebook: https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=254771540107924&id=100067252380999
3. Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41359>

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR RREGULLOREN PËR DHËNIEN E TITUJVE TË NDERIT, DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE NGA KOMUNA E RAHOVECIT

Me 08.04.2022, në uebfaqe zyrtare dhe në facebookun e komunës, është publikuar rikujtimi i njoftimit për mbajtjen e konsultimit publik, në të njëjtën ditë përmes emailit rikujtimi i njoftimit u është dërguar, drejtorëve të shkollave, OJQ-ve sportive dhe OJQ-ve kulturore. Rikujtimi i njoftimit OJQ-ve sportive, OJQ-ve kulturore dhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve u është dërguar edhe përmes rrjetit social viber.

KONSULTIMI PUBLIK

Më datë: 12.04.2022 mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, kryetarët e këshillave të fshatrave, drejtorë të shkollave, përfaqësues të OJQ-ve, dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën: <https://kk.rks.gov.net/rahovec/news/eshte-mbajtur-konsultimi-publik-me-qytetare-per-projekt-rregulloren-per-dhenien-e-titujve-te-nderit-mirenjohjeve-dhe-dekoratave-te-komunes-se-rahovecit/>

Konsultimi publik filloi në orën 13:00.

Konsultimin e shpalli të hapur Afrim Dina-Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport



Afrim Dina- kryesues i grupit punues për hartimin e Rregullores për dhënie të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit, ka bërë prezantimin e Rregullores duke thënë se, ka thënë se me këtë Rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe procedura për dhënie të nderit, çmimeve, dekoratave, mirënjohjeve dhe medaljeve nga Komuna e Rahovecit për qytetarët,

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR RREGULLOREN PËR DHËNIEN E TITUJVE TË NDERIT, DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE NGA KOMUNA E RAHOVECIT

personat juridik, shtetasit e huaj dhe organizatat e ndryshme për merita të veçanta dhe kontribute në Komunën e Rahovecit.

“Rregullorja është në diskutim publik nga data 28.03.2022 deri me 28.04.2022, rregullorja ka gjithsejtë 11 nene. Neni 1 Qëllimi, Neni 2, Fushëveprimi, Neni 3 Përkufizimet, Neni 4 Llojet e dekoratave dhe çmimet që i ndan Komuna e Rahovecit, Neni 5 Propozimet për ndarjen e dekoratave dhe titujvetë nderit, Neni 6 Forma dhe dukja fizike e dekoratave, Neni 7 Dorëzimi i dekoratës, Neni 8 Bartja dhe revokimi i titujve, Neni 9 Dekoratat dhe titujt e dhënë më parë, Neni 10 Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe Neni 11 Hyrja në fuqi.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datën 28.04.2022, në ora 16:00 në emailat: Afrim.Dina@rks-gov.net; Muharem.A.Morina@rks-gov.net, Blerta.Gashi@rks-gov.net; Skender.Hamza@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net”, është shprehur drejtori Dina.

Llojet e titujve dhe dekoratave që ndan Komuna e Rahovecit



Qemajl Krasniqi-Zyrtar i lartë nga drejtoria e Kulturës paraqiti llojet e dekoratave dhe çmimeve që përmban Rregullorja:


Dekorata "Qytetar nderi" i Komunës së Rahovecit u jepet qytetarëve që nuk janë banorë të Komunës së Rahovecit për kontribut të përgjithshëm në të mirën e përgjithshme, për çështje kombëtare, liri dhe pavarësi.

"Medalja e lirisë" u jepet familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe luftëtarëve për çlirimin e atdheut në periudha

të ndryshme të historisë kombëtare.

Dekorata "Nderi i komunës", u jepet individëve për kontribute në promovimin e Komunës së Rahovecit dhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror.

Dekorata “Ukshin Hoti” – u jepet personaliteteve të shquara të fushës së politikës, familjeve emblematike dhe individëve që kanë kontribuar për liri, dinjitet njerëzor e kombëtar, aktivistëve për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave historike - kombëtare shqiptare dhe atyre që janë shquar për vlerat universale humaniste e civilizuese. **Dekorata “Ukshin Hoti”** mund t’u jepet edhe personave të huaj që kanë kontribuar për çështjen shqiptare apo edhe për mbrojtjen e vlerave civilizuese e humaniste.



Dekorata për humanizëm “Dr. Ali Sokoli”, u jepet personave që merren me aktivitete humanitare apo atyre që me punën dhe përkushtimin e tyre humanist kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të jetës e të punës për njerëzit në nevojë.

Çmimi letrar “Sulejman Krasniqi”, u jepet personave me kontribute në krijimtarinë letrare-artistike, personave që ndikojnë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare, në ruajtjen e trashëgimisë historike dhe në pasurimin e jetës kulturore-

artistike. Ky çmim ndahet nga një juri profesionale në Ditën e Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi” më 7 dhjetor.

Çmimi “Lexuesi i vitit”, i jepet lexuesit/es – banor/e i/e Komunes së Rahovecit, për numrin më të madh të librave të lexuar gjatë një viti kalendarik, i cili është anëtar i rregullt i Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi”, apo edhe personit i cili me punën dhe përkushtimin personal ka arritur të nxisë të lexuarit dhe krijimtarinë letrare – artistike tek të rinjtë.

Afrim Dina: Faleminderit për paraqitjen e Rregullores, i nderuar Qemajl Krasniqi. Tash hapim debatin për këtë dokument dhe kushdo që ka ndonjë koment apo edhe sugjerim ta marrë fjalën.

Komentet dhe sugjerimet tuaja, anëtarët e grupit punues do t’i trajtojnë me kujdes dhe më pastaj do të vendosin nëse do t’i inkuadrojnë në dokumentin final.

Nuk pati asnjë koment nga të pranishmit. Konsultimi publik përfundoi në orën: 14:00

Dokumenti i Rregullores u është dorëzuar fizikisht pjesëmarrësve në konsultim publik.

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR RREGULLOREN PËR DHENIEN E TITUJVE TË NDERIT, DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE NGA KOMUNA E RAHOVECIT

LISTAT E NËNSHKRIMEVE

Republika e Kosovës
Komuna e Rahovecit
Kryetari i Komunës: Vllamir Krasniqi
Zyra për Edukation

Lista e nënshtetësve të cilët kanë marrë pjesë në konsultim publik për Projekt-Rregulloren për dhënie të titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit.

Emri	Stambori	Vendi	Nr. Tel	Nr. Shkollor
1. REXHA	MURATA	RAHOVEC	044 722 111	
2. ALI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
3. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
4. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
5. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
6. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
7. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
8. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
9. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
10. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
11. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
12. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
13. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
14. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
15. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
16. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
17. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
18. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
19. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
20. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	

Prograshtin D.A. Krasniqi
Nënshtetësi: [Signature]
Data: 12.04.2021


Republika e Kosovës
Komuna e Rahovecit
Kryetari i Komunës: Vllamir Krasniqi
Zyra për Edukation

Lista e nënshtetësve të cilët kanë marrë pjesë në konsultim publik për Projekt-Rregulloren për dhënie të titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit.

Emri	Stambori	Vendi	Nr. Tel	Nr. Shkollor
1. REXHA	MURATA	RAHOVEC	044 722 111	
2. ALI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
3. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
4. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
5. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
6. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
7. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
8. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
9. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
10. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
11. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
12. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
13. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
14. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
15. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
16. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
17. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
18. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
19. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	
20. HAKI	RAHOVEC	RAHOVEC	044 722 111	

Prograshtin D.A. Krasniqi
Nënshtetësi: [Signature]
Data: 12.04.2021

Numri i pjesëmarrësve në konsultim 19



Blerta Gashi



Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e konsultimeve publike